



Republika e Kosovës
Republika Kosovon - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Nënkomisioni për Mandate, Imunitete

dhe Rregulloren e Kuvendit

Mbledhja, nr. 09

Prishtinë, më 22.7.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Armend Zemaj, Selvije Halimi, Danush Ademi, Albulena Haxhiu
Enver Hoti dhe Milena Miliqeviq.

Mungoi: Donika Kadaj-Bujupi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Kaltrina Ahmeti – GLPS, Arton Demhasaj – ÇOHU,
Dibran Istrefi – Klan Kosova, Shkëlqim Hysenaj dhe Alban Gashi – KTV, Etleva Skonja –
Kosova Sot, Blerta Bejtullahu – EUSR/EV Office, Ismail Shabani – Kosova Press dhe Armend
Shkoza – Këshilltar GP LVV.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Armend Zemaj, kryetar i Nënkomisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i kërkesës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, për heqjen e imunitetit
për Enver Hasanin dhe Arta Rama Hajrizi;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Shqyrtimi i kërkesës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, për heqjen e imunitetit
për Enver Hasanin dhe Arta Rama Hajrizi;**

Kryetari tha se tanimë keni marrë kërkesën e Gjykatës Themelore në Prishtinë, për heqjen e
imunitetit për Enver Hasanin dhe Arta Rama Hajrizi. Meqë kemi marrë këtë kërkesë është mirë

që ta japim një përgjigje për Gjykatën themelore, kuptohet përmes Komisionit për Legjislacion. Ai propozoi që shkresa e Nënkomisionit për Komisionin për Legjislacion të përmbajë 4 pika themelore, si:

- Nuk bie në fushëveprim të komisionit çështja e heqjes së imunitetit për zyrtarët e lartë;
- Në kompetencë të komisionit bie vetëm shqyrtimi i kërkesave për heqjen e imunitetit dhe mandatit të deputetëve;
- Mandati për z. Enver Hasani ka përfunduar dhe i njëjti tani nuk ushtron funksionin e gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese;
- Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, në rastin nr. KO98/11, ka sqaruar çështjen e imunitetit.

Ai arsyetoi këto pika duke thënë se me gjithë faktin që nuk bie në fushëveprimin e Komisionit dhe se, z. Hasani nuk është më gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vlerësohet e nevojshme të jepen disa sqarime, në lidhje me imunitetin e zyrtarëve të lartë. Kjo, duke e pas parasysh edhe faktin se në shkresën e dërguar nga ana e Gjykatës Themelore, është përmendur edhe kryetarja aktuale e Gjykatës Kushtetuese, znj. Arta Rama-Hajrizi. Fillimisht duhet cekur se Gjykata Kushtetuese, në aktgjykimin e cekur më lart, ka vendosur në lidhje me imunitetin e organeve të ndryshme të Republikës së Kosovës, kryesisht të deputetëve të Kuvendit të Kosovës, anëtarëve të Qeverisë dhe Presidentit. Gjykata ka konstatuar se kemi të bëjmë me të ashtuquajturin *imunitet funksional*, i cili nënkupton se zyrtarët e lartë janë të mbrojtur nga çdo ndjekje penale dhe padi civile, për vendimet, veprimet dhe mendimet e shprehura gjatë kohës deri sa të njëjtët janë duke ushtruar funksionin e tyre. Pra, imuniteti, nuk është i lidhur me personin si i tillë, por lidhja kauzale në këtë rast bëhet me funksionin të cilin ai e ushtron. Çdo person që vishet me një funksion të lartë zyrtar, njëkohësisht vishet edhe me imunitet funksional. Ky lloj imuniteti, specifikë të veten e ka faktin që po të njëjtët persona, për veprimet që i marrin jashtë funksionit të tyre zyrtar, nuk gëzojnë imunitet, pra ata nuk përjashtohen nga përgjegjësia penale për veprimet individuale të tyre, e as nga paditë civile. Është praktikë e krijuar, që rastet e Gjykatës Kushtetuese krijojnë precedent për të njëjtën çështje, përveç kur një gjë e tillë nuk parashihet në vet vendimin e marrë nga ajo, dhe në këtë mënyrë bëhen burim i së drejtës. Edhe doktrina juridike shërben si burim plotësues i së drejtës. Andaj, kur kemi të bëjmë me rastin e imunitetit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, rasti për imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, anëtarëve të Qeverisë dhe Presidentit, vlen edhe për gjyqtarët e kushtetueses. Pra, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese gëzojnë imunitet funksional për të gjitha veprimet, vendimet dhe mendimet e shprehura brenda funksionit të tyre që ushtrojnë, por nuk gëzojnë imunitet jashtë funksionit të tyre zyrtar.

Pra, Gjykata Kushtetuese në pikën 111 dhe 112, të aktgjykimit, nuk i ka dhënë relevancë procedurës së heqjes së imunitetit, pasi që ka sqaruar në detaje çështjen e imunitetit. Ajo shkon edhe më tej, duke i vlerësuar pa vlerë juridike dispozitat e Rregullores së Kuvendit (neni 23), ku siç thuhet, tentohet t'u jepet imunitet deputetëve nga ndjekja penale. Në fund, tha se kjo do të ishte një përgjigje që duhet të adresohet në për Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Selvije Halimi, shprehu habinë se si gjykata ka kërkuar heqjen e imunitetit për zyrtarët e theksuar, kur dihet mirë fakti që kjo çështje tashmë është sqaruar. Meqë tani kemi një kërkesë do të ishte mirë që shumë formalisht ti kthehet një përgjigje, pasi që kjo çështje nuk bie në fushëveprim të Komisionit, sepse kjo çështje tashmë është sqaruar me aktgjykimin KO98/11.

Albulena Haxhiu, tha se kur flitet për Enver Hasanin, nuk mund të mos them se i njëjti është dashur tash e sa kohë të hetohet për aferat dhe skandalet të cilat i ka bërë, kjo nuk ka ndodhë për shkak të kapjes së secilit institucion. Për këtë çështje e kam lexuar kushtetutën, komentuarin

dhe aktgjykimin dhe vërehet se secila bie ndesh njëra me tjetrën. Pra kjo kushtetutë duhet të rishikohet sepse dispozitat e saj lënë shumë hapësira për interpretim. Për këtë çështje jam konsultuar edhe me ekspertë dhe me përfaqësues të shoqërisë civile dhe për këtë kam marr tri qëndrime të ndryshme. E pra është konsideruar se Kuvendi nuk ka kompetencë t'ua heq mandatin e zyrtarëve tjerë që nuk janë deputet.

E dyta, Kuvendi ka të drejtë të heq mandatin për zyrtarët që vet i zgjedhë dhe e treta, institucioni kompetent për heqjen e imunitetit është presidentja, për faktin se për këtë rast Kuvendi vetëm i propozon anëtarët e Gjykatës Kushtetuese te Presidentja dhe ajo i zgjedh. Personalisht mbështes propozimin e tretë, meqë presidentja është ajo që i zgjedh Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese. Ndoshta kjo do të ishte mënyra më e mirë që ti delegohet presidentes.

Ai duke u ndërlidhur me diskutimin e deputetit Zemaj, tha se Enver Hasani dhe Arta Ramaj, pikërisht duke ushtruar funksionin e gjyqtarit kanë keqpërdorur detyrën zyrtare dhe propozoi që kjo çështje të procedohet në Komisionin për Legjislacion, në mënyrë që në përbërjeje të plotë, siç tha ky, të vendosin për këtë çështje.

Armend Zemaj, tha se është e kuptueshme që do të vendos Komisioni por ne si nënkomision. Duhet t'ia procedojmë Komisionit një përgjigje dhe kjo përgjigje të jetë ashtu siç e propozova, pasi që përfshin të gjitha ato që u diskutuan nga parafolësit. Kjo përgjigje do të zgjidh dilemat edhe për të ardhmen kur flitet për imunitetin.

Albulena Haxhiu, ngriti shqetësimin se kjo shkresë, një muaj me vonesë u ka ardhur dhe se kjo nuk ka të bëjë me ndonjë lëshim të Kuvendit. Pra një muaj me vonesë, kur Enver Hasanit i kishte përfunduar mandati si gjyqtar.

Pas diskutimeve, Nënkomisioni vendosi që Komisionit për Legjislacion t'ia paraqesë këtë përgjigje, sipas arsyetimeve të dhëna nga kryetari:

- Nuk bie në fushëveprim të Komisionit çështja e heqjes së imunitetit për zyrtarët e lartë;
- Në kompetencë të Komisionit bie vetëm shqyrtimi i kërkesave për heqjen e imunitetit dhe mandatin të deputetëve;
- Mandati për z. Enver Hasani ka përfunduar dhe i njëjti tani nuk e ushtron funksionin e gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese;
- Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, në rastin nr. KO98/11, ka sqaruar çështjen e imunitetit.

3. Të ndryshme.

Në këtë pikë nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit

Kryetari i Nënkomisionit

Armend Zemaj